Kronikë

Lëvizte i armatosur, arrestohet 57-vjeçari në Fier! Babai i Azgan Mernicës që vrau në 2024 efektivin e 'Shqiponjave' (VIDEO)

I arrestuari është Petrit Mërnica, i cili u kap një lokal të zonës teksa me vete iu gjet 1 armë zjarri pistoletë së bashku me 2 krëhëra me nga 7 fishekë, të cilat i mbante në çantën e dorës.

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
23 Nëntor, 13:12 | **Përditesimi: 23 Nëntor, 14:02**

Share

Një 57-vjeçar është arrestuar nga policia e Fierit teksa lëvizte i armatosur në fshatin Fermë Çlirim.

I arrestuari është Petrit Mërnica, i cili u kap një lokal të zonës teksa me vete iu gjet 1 armë zjarri pistoletë së bashku me 2 krëhëra me nga 7 fishekë, të cilat i mbante në çantën e dorës.

Petrit Mërnica ka bërë më parë 20 vite burg për vrasjen e kunatit të tij. Gjithashtu ai është babai i Azgan Mërnicës, i cili në vitin 2024 qëlloi për vdekje me plumb në kokë efektivin e 'Shqiponjave' Novruz Canaliaj.

[Sh.com]

LEXO EDHE:
Mungesa e ujit të pijshëm, një grup aktivistësh në Fier ngrihen në protestë: Ndërprerja bëhet pa paralajmërim, duhet zgjidhje

"Fier / Finalizohet operacioni policor i koduar "Pathëay".

Lëvizte i armatosur me pistoletë me vete, kapet në flagrancë dhe vihet në pranga 57-vjeçari, i dënuar më parë për vrasje.

Sekuestrohet arma e zjarrit pistoletë me 2 krëhëra me municion luftarak.

Shërbimet e Forcës së Posaçme Operacionale, në bashkëpunim me Seksionin për Hetimin e Krimeve Kundër Personit dhe shërbimet e Komisariatit të Policisë Fier, në vijim të punës për evidentimin dhe goditjen e rasteve të armëmbajtjes pa leje, bazuar edhe në informacionet e siguruara për një shtetas që lëvizte i armatosur, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar "Pathëay".

Gjatë operacionit, shërbimet e Policisë kanë kapur në flagrancë, në një lokal në fshatin Fermë Çlirim, shtetasin P. M., me 1 armë zjarri pistoletë, me 2 krëhëra me nga 7 fishekë, që i mbante në çantën e dorës.

Në vijim të veprimeve procedurale, specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Fier arrestuan shtetasin P. M., 57 vjeç, banues në fshatin Sulaj, Fier, i dënuar më parë për vrasje.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Fierit, për veprime të mëtejshme", njofton policia.

K.B/r.k./Shqiptarja.com

TAG: azgan mernica | petrit mernica | Fier

Komento

Komente

Ben: 23/11/2025 14:13
Sa familje e bukur paska qene
Përgjigju

Kalbeni ne burg: 23/11/2025 14:04
Perpara se te marri perseri nje jete te pafajshme
Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.com

Sondazhi i ditës:
Kë ka luftuar më shumë SPAK deri sot?
20 Nëntor, 13:08

Korrupsionin | Krimin e organizuar | Asnjërën

Lajme të tjera

Makina u përfshi nga flakët pas përplasjes me mjetin tjetër! Publikohen pamjet nga aksidenti në Lushnjë-Rrogozhinë (VIDEO)
23 Nëntor, 14:55

Në kërkim për vjedhjen e një makine, arrestohet 46-vjeçari në Lushnjë! Në pranga edhe një tjetër (EMRAT+VIDEO)
23 Nëntor, 10:02

Moti i keq/ Përmirësim i situatës në Fier, ulet niveli i Vjosës dhe Semanit, tërhiqen ujërat nga tokat bujqësore
23 Nëntor, 07:37

Maskohej si grua për të thyer arrestin shtëpiak, nusja filmoi dhe nxori zbuluar 69-vjeçarin në Fier: Më futi burrin në burg, sherr për pronën

Marsela Topi
22 Nëntor, 17:55

Aksident në autostradën Lushnjë–Rrogozhinë, mjeti merr flakë pas përplasjes (VIDEO)
22 Nëntor, 16:45

Fier/ Të shtënat me armë në lokal, arrestohet njëri nga të përfshirët në konflikt dhe pronari! Ende në kërkim 33-vjeçari
22 Nëntor, 12:27

Semani del nga shtrati tek ura e Mbrostarit, përmbyten stalla me bagëti dhe toka bujqësore
22 Nëntor, 09:52

Fier/ Konflikt mes dy personave në një lokal, 33- vjeçari qëllon në dysheme me armë, policia i shpall në kërkim
21 Nëntor, 22:18

Lamallari mbledh në Fier drejtorët e burgjeve: Garantoni sigurinë dhe zbatimin e ligjit! Burgjet e komunizmit si muze në Shqipërinë Evropiane
21 Nëntor, 17:54

Të dënuar në Angli për prodhim të lëndëve narkotike, Prokuroria e Fierit sekuestron 15 prona e llogari bankare me vlerë 368 mijë euro të dy vëllezërve
21 Nëntor, 09:44

Fier/ Uji hyn në oborret e 30 banesave në Kashisht, Çerven e Ferras! Evakuohet një familje në Çerven! Lumi Seman del nga shtrati në fshatin Kallm
21 Nëntor, 08:58

Lumi Shkumbin del nga shtrati brenda argjinaturës, rrezikohen tokat bujqësore (VIDEO)
20 Nëntor, 11:03

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje